



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

RELACION TEKNIK

(KONTRATA NR.11)

Mirembajtje me performance rruga: "**Krumë – Qafë Prushi, Golaj (K/Plepa) – Kam**"

Përshkrim i përgjithshëm.

Akset rrugore "**Krumë – Qafë Prushi, Golaj (K/Plepa) – Kam**" janë segmente rrugore pjese e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkoder. Këto segmente rrugore janë pjesë e aksit kryesor që lidh Hasin me Gjakoven dhe Hasin me Bajram Currin. Segmentet klasifikohen si rrugë kryesore me 2 korsi levizje, me bankina 50-60 cm kuneta betoni. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 km. Plepa – Kam 3.5 km. Për nga shtrirja gjeografike ky segment perkufizohet me të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirembajtje rutine dhe dimerore.

Me poshtë paraqiten në formë tabelare segmentet rrugore që përbejnë këtë kontratë.

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Krumë - Qafë Prush	17.3	42°12'17.4"	20°24'33.2"	42°18'06.9"	20°22'58.7"
2	Golaj (K/Plepa)- Kam	23.1	42°15'21.0"	20°22'20.5"	42°14'56.8"	20°13'09.5"
Shuma (km):		40.4				

Kushtet e inspektimit.

Sot me datë 27.03.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore "**Krumë – Qafë Prushi, Golaj (K/Plepa) – Kam**". Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përlllogaritjen e fondit limit, si objektivi i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029), me qëllim hartimin e preventivave për përlllogaritjen e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .

Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike të përqendruara më shumë në segmentin "**Krumë – Qafë Prushi, Golaj (K/Plepa) – Kam**". Ka një përmirësim të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrone. Gjithashtu rezultojnë edhe një shtim i konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike kryesisht në tre akset rrugore. Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon nëpër një terren të theksuar malor, dhe çdo vit përballet me kushte të vështira atmosferike, vërehet se aksi ka nevojë të metejshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve rrugore që përmendëm më sipër, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme.

Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.

- Segmenti rrugor "**Krume-Plepa**" 11 km. është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt. Pothuajse gjatë gjithë segmentit ne km e pare i dallohen një numër i madh parapetesh betoni të dëmtuara. Kërkojmë që të riparohen të gjitha parapetet sic janë të betonit. Po kështu është parashikuar një sasi vijezi. Vija e mesit nga 0-11 km, gjerësia 15 cm. Në km 7 është parashikuar një germim të skarpates për arsye të rritjes së fushpamjes në këto. Megjithatë rruga është përmirësuar nga ana e sinjalistikës vertikale përderisht kemi evidentuar disa përmirësime të metejshme sipas tabelave që do të miratohen gjatë 4 viteve të ardhshme.

- Segmenti rrugor "**Plepa – Qafë Prush**" (7 km) është një segment gjysëm malor. Në këtë segment rezultojnë disa pjesë të asfaltit të dëmtuara që kanë nevojë për riparime pasi në vitet e ardhshme mund të ndikojnë në përkeqësimin e situatës. Vendndodhjet për të kryer riparimet janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa pjesë të rrugës ku është pare e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

nga ujrat eshte menduar ndertimi kunetave me bordure, vendndodhjet jane percaktuar me tabela eshte parashikuar nderhyrja rrafshime shpate ne km 2.3 dhe 4.

Ne km 2 kemi evidentuar shembje dheu, te ndertohtet mure betoni 17 ml te gjate. Ne km 5 kemi evidentuar shembje toke, te ndertohtet muri betoni 14 ml te gjate. Eshte parashikuar te behet vijezimi I vijes se mesit nga 0-7 km ,gjeresi 15 cm. Kemi kerkuar permiresim te sinjalistikes qe do te nevojitet 4 vitet e ardhshme ne vizimet edhe ne zonat e banuara.

Segmenti “**Plepa-Kam**” **22.4 km** eshte segment i plotesuar kryesisht me sinjalistike vertikale dhe horizontale. Rezulton segment momentalisht si eshte nderhyre pjeserisht ne permiresimin e shtresave rrugore. Shtresat afaltike jan ne gjendje mesatare. Ne disa zona jane percaktuar me hollesisht ne tabelat e shperndarjes se punimeve.

Ne km 14.15 eshte parashikuar germimi shpatit per te rritur fushepamjen. Gjithashtu kemi parashikuar ne km 20, km 21, km 22.4 edhe ndertimin te keto zona kunetave anesore me bordure pasi jane te demtuara totalisht duke sjelle si pasoje vershimin e ujrave brinje buzes se asfaltit duke u ber shkak per demtimin e tij.

Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasitë e këtyre punimeve ti paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet me te lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave te rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shperndarjes se punimeve te rehabilituse periodike.

Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :

Nr.Ana	Përshkrimi I punimit	Njesia	Sasia
	1. PUNIME GERMIMI		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.119/a	Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne toke,	m3	320
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	650
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	800
3.161/2	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.25m ³	m2	550
2. PUNIME SHITESASH			
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	255
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	255
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	255
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	255
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	11580
3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	35
3. ANALIZA TEKNIKE			
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2	1700
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	11580
4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE			
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	660
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	85
5. PUNIME HEKUR BETONI 3			
3. 287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 288	F V hekur betoni i zakonshem $\emptyset > 12\text{mm}$	ton	0.2
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, Ilaç çimento M50	m3	495
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	120
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	84
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	15
3. 366	Tombino me tuba betoni $\emptyset 800$, mbi shtrese betoni	ml	8
	7. PUNIME TE NDRYSHME		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	120
	8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	12
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	1650
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	20
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	32
	11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	44
3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	30
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	26
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	10
3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	210



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	46
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	38
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	30
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	440
3. 165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	18

Foto nga inspektimi në terren.

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Bashkangjitur ketij relacioni jane edhe fotot dhe tabelat e shperndarjes se punimeve te rehabilituse periodike :





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR



GRUPI I PUNËS :

